

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Artan Hoxha: Si arriti Agasi të përdorte Kadastrën e AKSHI-n? Sot i thonë biznesmen, po si u bë miliarde r?
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/24/artan-hoxha-si-arriti-agasi-te-perdorte-kadastren-e-akshi-n-sot-i-thone-biznesmen-po-si-u-be-miliarder/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 20:33:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 20:31:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2cb92f4720a2d813a8e85dde854e6dc7c2de31566ded6e6046c4381c1b921075
TEKSTI	e1bb5b760dbc4013e2ef2076cbd2b788a62165830a9d3f436090c6b211e2e5ad
PAMJA	1d14577b6d62716e1cc86fefb412338d92fac5818ccacd0e0b9d9a3b3ebf6083

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6c3184671b84fa5be2926b03b89579b2aec66f5937b02383b8ea55b3150398c7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	de40688aef4c4ba129d7a84fd77d2b1b27a16260a8d1d580a5a1a060453e9f69
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/6c3184671b84fa5be2926b03b89579b2aec66f5937b02383b8ea55b3150398c7

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Artan Hoxha: Si arriti Agasi të përdorte Kadastrën e AKSHI-n? Sot i thonë biznesmen, po si u bë miliarder?

22:31 : 24/09/2026 në AKTUALITET, Lajmet e Dites



Gazetari Artan Hoxha ka komentuar zhvillimet e fundit rreth ish-drejtores së SHISH, Vlora Hyseni dhe Ergys Agasit, duke pretenduar se çështja nuk duhet parë vetëm si një histori e izoluar, por si pjesë e një mekanizmi më të gjerë pushteti.

I ftuar në “Çim Peka LIVE”, Hoxha tha se zhvillimet e fundit tregojnë se “gurët po bien me radhë”, ndërsa e vendosi Hysenin brenda një rrethi më të gjerë që, sipas tij, lidhet me mënyrën se si funksionon pushteti i Edi Ramës.

Sipas gazetarit, Agasi nuk ka pasur vetëm një rol të kufizuar, por ka fituar me kalimin e kohës ndikim mbi struktura dhe institucione të ndryshme shtetërore.

Hoxha përmendi Policinë, Kadastrën, AKSHI-n dhe institucione të drejtësisë, duke pretenduar se ndikimi i tij shtrihej deri te SPAK dhe GJKKO.

“Si arriti ky njeri të përdorë gjithë shtetin? Të gjithë agjencitë. Policinë, Kadastrën, Hipotekën, AKSHI-n”, deklaroi Hoxha.

Lexo edhe:

[“Do plasë skandali te Kadastra”, Peka: Këshilli i Rregullimit të Territorit është bastisur nga SPAK](#)[Nesho: Rama, arkitekti i lidhjes politike–krim](#)

Një pjesë e rëndësishme e deklaratës së gazetarit lidhej edhe me përgjimet. Hoxha ngriti pikëpyetje mbi mënyrën se si janë kryer përgjimet parandaluese dhe nëse për to janë respektuar procedurat ligjore.

Ai iu referua rregullave për autorizimin e përgjimeve parandaluese, duke pretenduar se nga zhvillimet e fundit ngrihen dyshime nëse këto procedura janë zbatuar në mënyrën e parashikuar nga ligji.

Më tej, Hoxha hodhi akuza edhe për ndërhyrje të pretenduara në procese institucionale, duke përfshirë zgjedhjen e kreut të SPAK. Ai pretendoi se kandidatëve për KLP u është përcjellë një qëndrim politik lidhur me votimin.

TË GJITHA



Artan Hoxha: Si arriti Agasi të përdorte Kadastrën e AKSHI-n? Sot i thonë biznesmen, po si u bë miliarder?

22:31 : 24/09/2026



“Do plasë skandali te Kadastra”, Peka: Këshilli i Rregullimit të Territorit është bastisur nga SPAK

22:21 : 24/09/2026



Nesho: Rama, arkitekti i lidhjes politike–krim

22:16 : 24/09/2026



Çfarë iu gjet Agasit? Gazetaria: Materiale të SHISH për zyrtarë të rëndësishëm shtetërorë

22:03 : 24/09/2026



Sherr mes Lalës dhe Rexhajt: Meriton të rrihesh siç të rrihte Buzhala, por s’i ndyji duart me ty

22:02 : 24/09/2026



“Në hotel me agjentë serbë”, Lala i kthehet Vlora Hysenit: Zgjedhi njeriun e gabuar...

21:44 : 24/09/2026



Gazetaria zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

21:38 : 24/09/2026

Këto pretendime të gazetarit nuk përbëjnë, në vetvete, një konstatim gjyqësor dhe kërkojnë verifikim nga institucionet përkatëse.

Në fund, Hoxha u ndal te ngritja ekonomike e Ergys Agasit, duke vënë në pikëpyetje mënyrën se si ai kaloi nga një punonjësi i thjeshtë në një person që sot, sipas gazetarit, trajtohet si biznesmen me pasuri të konsiderueshme.

“Si arriti ky njeri? Nga erdhi ky?”, pyeti Hoxha, duke shtuar se kërkon të dijë se si u krijua pasuria e Agasit.

Deklaratat e gazetarit vijnë në një moment kur hetimi ndaj Vlora Hysenit dhe materialet e sekuestruara në kuadër të dosjes kanë rikthyer në vëmendje marrëdhëniet mes personave pranë pushtetit, strukturave të sigurisë dhe institucioneve shtetërore.

Etiketa: artan hoxha, Edi Rama, Ergys Agasi, kip, spak

Lajme të lidhura



“Do plasë skandali te Kadastra”, Peka: Këshilli i Rregullimit të Territorit është bastisur nga SPAK

22:21 : 24/09/2026



Nesho: Rama, arkitekti i lidhjes politike–krim

22:16 : 24/09/2026




Çfarë iu gjet Agasit? Gazetarja: Materiale të SHISH për zyrtarë të rëndësishëm shtetërorë

22:03 : 24/09/2026



Gazetarja zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

21:38 : 24/09/2026



Mbyllen fjalimet para Kryeministrit, qytetarët nisin marshimin: Rama jepe dorëheqjen

21:09 : 24/09/2026



Kush ia dërgoi Agasit aktin e ekspertimit të kriminalistikës për gjurmë gishti, fije floku dhe...

21:03 : 24/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

